



PROCESVERBAL VIII/2022

I mbajtur me rastin e mbledhjes së IX (nëntë) për vitin 2022 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi:	KK Suharekë
Zyra:	Salla e Bordit të Drejtorëve
Data:	16.09.2022
Ora :	13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Nënkryetarja e Komunës znj. Mihrije Suka
Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2023;
3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin e propozimit të komisionit për ndarjen e çmimit “ Ukë Bytyçi “ ;
4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;
5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës - 2022-2030(HZK);
6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik ;
7. Shqyrtimi i raportit vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditorit të brendshëm për periudhën janar-dhjetor 2021 ;

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar ;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2023;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - përshëndet të pranishmit. Ne kemi qenë në takimin e 6 shtatorit dhe ideja ka qenë që ne me dhanë kontributin tonë para se ky dokument me ardhë si dokument final, në mënyrë që ky buxhet me qenë sa ma i mirë dhe mi adresu sa ma shumë kërkesat e qytetarëve. Në atë takim unë i kam dhënë disa vërejtje dhe më vie mirë që 80 % e atyre vërejtjeve që i kam dhënë janë marrë parasysh. Dokumenti që na keni sjell në KPF i ka të evidentune sidomos vërejtjet e mia që i kam dhënë dhe janë heq shumica prej tyre që unë i kam paraqit. Në anën tjetër këtë dokument që e keni sjell e kam studiu më në detaje dhe ajo që kam pa janë dy shembuj që për mu janë tepër shqetësuese. P.sh. në Gelancë ju keni parapa për vitin 2023 ndërtimin e rrugëve lokale: Azman Alija ,Kodra e Nurës, Fisnikët, Qershia, Daut Rexhepallari dhe Gani Kukaj. Por ajo që më shqetëson është se unë kam pa që ju keni nënshkruar një kontratë për Gelancë, ku më shumë se gjysma e rrugëve që keni planifiku për vitin e ardhshëm i keni në kontratë për m’i ndërtu sivjet. Në Mushtisht për vitin 2023 keni planifiku ndërtimin e rrugëve: Rexhep Velija, Morika, Shaljanët, Tafa, Ilaz Shala, Gentiana, Haxhi Shania, Avdyl Aga, Jetush Shala, Kovaqi. Në një Kontratë që ju e keni bo për vitin 2022, rezulton që gati 80 % e këtyre rrugëve i keni në kontratë për sivjet. Për mu është i papranueshëm ky

planifikim dhe uroj që ju keni ndonjë arsyetim. Dy shqetësimet e mia në takimin e 6 shtatorit që ju nuk i keni marrë parasysh, përveq tjerave që i keni marrë parasysh, është blerja e veturave në vlerë 100.000 euro për komunë, e që mua më duket lluks i madh edhe pse ndoshta jam gabim. Tjetra është: Ndërtimi i infrastrukturës së oborrit të objektit të Komunës dhe ndërtimi i objektit të ri të Komunës. Nëse doni me ndërtu objekt të ri, pse po mendoni me investu në oborr? Është pak e pakuptimtë. Te ndërtimi dhe funksionalizimi i QMF-ve, ju keni planifiku 380.000 euro për Studenqan dhe Gjinoc, por paradoksi është që ju për sivjet keni bërë kontratë për mi rregullu oborret. Për ne ky buxhet është i pa përgatitur mirë dhe ne mendojmë që nuk meriton me ardhë as sot për Asamble dhe as në Asamble mu miratu.

Kryesuesi - te rrugët që përmende në Gelancë dhe Mushtisht, një pjesë e rrugëve figurojnë mirëpo ka mundësi që nuk kryhen sivjet dhe Kompania i kryen vitin e ardhshëm, sepse edhe kontratat me Kompanitë janë dy vjeçare. Për atë edhe duhet të figurojnë emrat e atyre rrugëve për vitin 2023. Sa i përket oborrit të Komunës dhe 50.000 euro me bashkëfinancim, ne normal do ta rregullojmë oborrin e Komunës me pretendimin që me gjet një donator, MAPL-në që në bashkëpunim me ta me fillu. Te blerja e veturave, gjendja e veturave është shumë e keqe.

Urim Suka - mundet me qenë ajo që thoni ju, por unë e kam një pjesë të kontratës për Gelancë këtu, ku thuhet: kontrata hyn në fuqi me datën e nënshkrimit 17.05.2022 dhe përfundon brenda 90 dite pune.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime rreth çështjes së prokurimit dhe thotë që 90 ditë pune numërohen vetëm ditët që punohet.

Dardan Berisha - përshëndet të pranishmit. Është e vërtetë që me 06.09.2022 kemi dhënë disa ide dhe shqetësime tona, por disa janë marrë parasysh dhe disa jo. Specifikimi i rrugëve rrugore ka qenë shqetësim i secilit prej nesh. Për atë që e ngriti Urimi është dasht me qenë prezent drejtori i shërbimeve publike dhe me dhanë sqarime. Te qyteti i Suharekës: Ndërtimi dhe rregullimi i varrezave në Biraq, a është e ndanë parcella për këtë?

Sanie Kuçi Rexhepaj - në vitin 2021 është hartu projekti kryesor i varrezave në Biraq. Projekti është projekt në faza dhe janë 8-9 faza. Në takimin që kemi mbajtur atë ditë, e kam pyetur drejtorin për këtë projekt dhe tha që ka fillu dhe tash OSHP-ja e ka kthyer në vendim dhe ka me fillu me zonën e parkingut dhe kapellën. Mandej vitet e ardhshme do të vazhdohet me pjesët e varrezave.

Dardan Berisha - mua më interesoj të di, a ka me u rrethuar, a ka me u vendos beton?

Sanie Kuçi Rexhepaj - terreni nuk është i rrafshët dhe rrethojat janë prej mureve të betonit.

Dardan Berisha - te Drejtoria e Urbanizmit e kam ngrit si shqetësim shenjëzimin dhe vendosjen e tabelave në disa pika ku duhet patjetër të vendosen.

Kryesuesi - e ka marrë përsipër këtë çështje Drejtori i Urbanizmit.

Dardan Berisha - nuk e kam has në material Mirëmbajtjen e lapidarëve të dëshmorëve.

Urim Suka - e kam kontratën që e keni lidh me Eko Regjionin dhe në atë kontratë parashihet 4 herë në muaj pastrimi i rrugëve edhe nëpër fshatra. Unë nuk di që kanë ardhur një herë me pastru rrugë.

Liridon Fandaj - te projektet kapitale vërejtjet që kemi dhënë, disa janë marrë parasysh e disa jo. Por mua më shqetëson fakti që Drejtori i Financave nuk ka marrë pjesë në mbledhje, as herën e kaluar e as tash, edhe pse ky buxhet është i rëndësishëm për Komunën. Ndërlidhem te Urimi që tha për projektet e vitit të kaluar që vazhdojnë edhe këtë vit, dhe unë mendoj që projektet kapitale nese kalojnë vitin tjetër duhet të shënohen si segment. Janë pagu projekte që ende nuk janë ekzekutu. Në dëgjime publike, ato që janë kanë, nuk janë në buxhet dhe pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë e vogël. Nëse kështu vazhdohet pjesëmarrja e qytetarëve do të jetë edhe më e vogël, edhe unë më nuk marrë pjesë. P. Sh. në Peqan, herën e parë në dëgjime publike keni thënë 40.000 euro dhe tash në buxhet janë 20.000 euro. Për mua ky buxhet nuk shkon as në Asamble dhe jam kundër.

Urim Suka - gjendja është më keq se sa unë e kam paraqit sot. Kam fakte që ka rrugë që janë të shtrune ku ju keni lidh kontratë, dhe kërkoj sqarime në Asamble mbledhjen e ardhshme. Janë 8 rrugë të kontraktuara dhe 6 prej atyre rrugëve janë të shtrune. Edhe ky projekt buxhet ka emra të rrugëve që në fakt janë të shtrune.

Dardan Berisha - realisht ne jemi mundu me marrë pjesë edhe në dëgjime publike. Unë kur kam qenë opozitë kam marrë pjesë në dëgjime publike.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

**4 për, 3 kundër
Miratohet pika 2**

Pika 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin e propozimit të komisionit për ndarjen e çmimit “ Ukë Bytyçi “ ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Dardan Berisha - a ka pas kundërkandidat?

Kryesuesi - jo.

Dardan Berisha - a ka pas ftesë publike në faqen e Komunës ?

Kryesuesi - ftesa publike ka qenë e publikuar në faqe të Komunës me afat kohor.

Liridon Fandaj - a është banor i Komunës tonë?

Kryesuesi - në bazë të dokumentacionit është banor i Suharekës. E hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin

Sanie Kuçi Rexhepaj – ligjërisht, a nuk është e lejueshme që në Asamblenë e kalume me u miratu shpallja e ankandit publik dhe formimi i komisionit?

Avni Bytyqi - jo nuk mundet, për arsye se vendimi mandej e ka një shqyrtim të ligjshmërisë dhe supozojmë që nëse kthehet shqyrtimi i ligjshmërisë që është i kundërligjshëm atëherë edhe komisionit me automatizëm i kërkohet

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

Unanimisht Miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës -2022-2030(HZK);

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Bulëza Kuçi - kisha kërku sqarim edhe prej Sanies, ku ju e dini rastin që ne kemi pas kërkesë për Unicom dhe që është diskutu disa herë, ndërsa ajo kërkesë nuk u fut në Planin Zhvillimor Komunal. Kërkoj sqarim se pse nuk është fut kjo kërkesë edhe pse është miratu në Asamble dhe ju patët premtuar që është e kryer.

Kryesuesi - është e vërtetë që është miratu ai vendim me kërkesën tënde.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ndoshta do të ishte mirë me qenë Drejtori i Urbanizmit këtu, për shkak se sqarime të Haratave Zonale nuk muj me dhanë në këtë fazë, sepse nuk jam e përfshirë më në dokument, por muj me dhanë sqarim sa i përket PZHK-së pasi kam qenë Drejtoreshë mandatin e kalum. Në mbledhjen e Asamblesë kur është miratu PZHK-ja, Bulëza e ka ngrit një shqetësim, që njëra prej kërkesave të qytetarëve në fazën e shqyrtimit publik të PZHK-së nuk është azhuru në harta. Në mbledhjen e Asamblesë kam thënë që kjo kërkesë ka me u azhuru, dhe PZHK-ja është miratu me plotësim të kërkesë së Bulëzës. Ajo kërkesë është fut, është azhuru në PZHK dhe është dërgu për miratim final në Ministri dhe është e plotfuqishme. Tash në fazën e Hartave Zonale unë e kuptoj shqetësimin tënd dhe realisht duhet me marrë si shqetësim nga ana e qytetarit. E kontrollova edhe vet në hartat që janë të publikuara në faqe të Komunës dhe pashë që nuk është e azhurune. Ose është naj lëshim ose gabim teknikë. Të paktën, ju Kryesues me përcjell si shqetësim te Drejtori i Urbanizmit dhe në Asamble Komunale me u kontrollu, sepse nëse diçka është në fuqi në PZHK, është shumë e pa drejtë me u ndryshu jo në favor të qytetarit në Harta Zonale, për shkak se ky dokument hyn në fuqi për 8 vite dhe 8 vite janë të mëdhaja për me dëmtu një qytetar dhe aq më pak që atëherë komisioni dhe këshilli i ekspertave ja ka dhënë të drejtën me vndim dhe ia ka miratu kërkesën në fazën e PZHK-së. Pra PZHK është dokumenti më i rëndësishëm dhe secili plan që miratohet mas PZHK-së, duhet me qenë në harmoni me PZHK-në. Normalisht që në Harta Zonale kur e shohim që ka mujt me ik diçka, ki drejtë me i rregullu kufijtë ndërtimor, ose diçka që asnjëherë nuk e dëmton palën. Në këtë rast është

bo një lëshim që ndoshta është mirë ne si Asamble me pas sqarim se çka ka ndodh dhe si procedurë a mundet me u inkuadru,sepse dokumenti po hartohet dhe miratohet për qytetarë e pastaj për stafin e Komunës,që normalisht ia lehtëson punën se a është një dokument që i përmbledh të gjitha gjërat.Kërkojmë sqarimet e nevojshme në Asamble.

Bulëza Kuçi - kërkojmë sqarime dhe kërkojmë të futet kjo.

Kryesuesi - unë e marrë si të kryer pasi që thatë se PZHK-ja është dokumenti ma kryesor, dhe aty qenka dhe duhet me qenë edhe në Hartë Zonale ajo pjesë.

Liridon Fandaj - nëse e miratojmë ne Hartën Zonale,atëherë nuk mundet me u ndryshu.

Kryesuesi - kjo duhet të përmirësohet para se me shku në Asamble.Ia jep fjalën zyrtarit ligjor për sqarime shtesë.

Avni Bytyqi - çështja e proces dokumentit për planifikim hapësinor është ekskluzivisht kompetencë e Komunës dhe e Kuvendit, ta miraton dhe ta harton. Absolutisht as një kompetencë nuk e ka Ministria në çështjen e përzgjedhjes së kompetencave të Hartimit dhe Planifikimit Hapësinor sa i përket çështjes së nivelit, konkretisht Komunës së Suharekës. Ministria ka kompetencë dhe autoritet vetëm që ne si Komunë ti kemi të harmonizuara PZHK-në dhe HZK-në me Hartën e Kosovës dhe me Planin Zhvillimor të Republikës së Kosovës dhe me Strategjinë Kombëtare për Planifikim Hapësinor ,dhe a i kemi ndjekë të gjitha procedurat ashtu siç e thotë ligji. Kompetencë për miratimin e këtyre dokumentave është Kuvendi. Është e vërtetë ajo që thatë ju, që mandatin e kalum kur është miratuar PZHK-ja është miratu me një vërejtje, e cila vërejtje ka qenë e përfshirë edhe në procesverbal dhe kanë qenë të obliguar ekzekutivi që ta inkurpurojë në kuadër të PZHK-së. A është bërë apo jo ajo çështje, e sqaroi Sania. Mbetet me e procesu autoriteti i Planifikimit Hapësinor branda Komunës që a është në kuadër të PZHK-së ajo pjesë që është miratuar në Kuvend. Në të vërtetë ajo pjesë është inkuadruar në kuadër të PZHK-së,edhe në këtë rast autoriteti përgjegjës për Planifikim Hapësinor,Drejtoria për Urbanizëm ka për obligim që edhe Hartën Zonale ta inkuadruojë dhe në kuadër të HZK-së ta inkuadruojë atë pjesë e cila është inkuadruar edhe në PZHK, duke e harmonizuar me PZHK-në duke mos e dëmtuar as interesin e përgjithshëm të Komunës por në asnjë formë duke dëmtuar interesin e palëve.

Bulëza Kuçi - atëherë ne po i japim shtytje për Asamble duke shpresu me u përmirësu.

Liridon Fandaj - nëse inkuadruhet ajo pjesë në Hartë Zonale,a duhet me shku prap me marrë pëlqim në Ministri?

Avni Bytyqi - para se të miratohet në Kuvend, nëse shtohet një çështje apo duhet një nen apo një kërkesë në kuadër të dokumentit apo ligjit,ai duhet të inkuadruhet pasi të miratohet në dokument strategjik. Nëse miratohet harta Zonale me plotësim ndryshimet që kërkohen dhe që arsyetohen nga autoriteti përgjegjës, në këtë rast autoriteti përgjegjës ka për obligim që ta hartojë një raport të detajuar dhe ta cek që Kuvendi i Komunës ka kërku që të bëhen këto ndryshime në kuadër të planit të Hartës Zonale duke inkuadruar që është e parapanë në PZHK, por në asnjë formë nuk guxon që të jetë në kundërshtim me PZHK-në Harta Zonale. Zyrtari ligjor jep sqarime edhe rreth pëlqimit të HZK-së dhe thotë që 7 ditë pas miratimit të HZK autoriteti përgjegjës, Drejtoria për Urbanizëm ka për obligim që ta dërgon dokumentin e miratuar në Kuvend që Ministria përgjegjëse ta kontrollojë dhe ta konstatojë që është në harmoni dhe përputhshmëri me atë që e ka lëshu pëlqimin për HZK kur e ka miratu.

Sanie Kuçi Rexhepaj - në cilën do formë që miratohet HZK,çoftë me vërejtje apo pa vërejtje,Komuna e ka për obligim me dërgu planin e miratim në Ministri për shkak se përpos që ky dokument i shërben Komunës ndërkohë i shërben edhe Ministrisë .Për shkak se janë disa kategori të objekteve që Komuna nuk mundet me lëshu leje por i lëshon Ministria. Kryesues,mungesa e drejtorave në mbledhje është pak shqetësuese ,përveq Drejtorit të pronës që vje.Në mbledhjen e parë që e mbani çdo javë,të lutem me shpreh si shqetësim dhe në mbledhjen e KPF-së secili drejtor që ka pika të veta të jenë prezent.

Avni Bytyqi - sa i përket pëlqimit për HZK, e kam analizuar këtë çështje dhe vërtetë Ministria nuk e përmend që Harta Zonale duhet apo jo të jetë në përputhshmëri dhe harmoni me PZHK-në për arsye se është kompetencë e Komunës. Ministria e ka dhënë pëlqimin vetëm që HZK 2021-2030 është në harmoni dhe përputhshmëri me Planin Hapësinor të Kosovës dhe me strategjinë e Zhvillimit Hapësinor të Republikës së Kosovës.

Urim Suka - jam i pa përgatitur me trajtu këtë temë,por kam disa informata jo zyrtare që dokumenti në fjalë nuk i trajton edhe në mënyrën ma të mirë të mundshme çështjet. Pasi Sania ka qenë drejtoreshë, dua t'ia bëj një pyetje.Pse është i harmonizim Hartat Zonale me Planin Zhvillimor,se i njeiti autoritet i bën PZHK-në dhe HZK-në dhe mundeni me i harmonizu.A beson që ky plan që është bo,është ma i miri i mundshëm për Komunën tonë ,apo ne duhet mi hap sytë në këtë drejtim, me bo diçka ma mirë. Unë gjithmonë po thirrja në disa informata jo zyrtare,që Hartat Zonale pak a shumë janë të përdorura politikisht dhe në vende të caktuara,këtu bën ndërtim dhe këtu s'bën ndërtim.

Sanie Kuçi Rexhepaj - Komuna dhe qytetarët kanë shumë nevojë për këtë dokument.80 % e dokumentit është hartu kur unë kam qenë drejtoreshë dhe ka mbet vetëm çështja pas miratimit të PZHK-së.Ka vend për ma mirë e ma mirë,por këto aludimet të çështjeve me të njohfshëm nuk qëndrojnë sepse nuk është hera e parë që Komuna ka dokumente planifikimi,por ka pas para lufte dhe mbas lufte,e ka në fuqi PZHK--në Komuna dhe pak a shumë ne jemi bazu në ato plane.Komuna ka nevojë shumë për këtë dokument dhe nuk i kisha dhënë asnjë lloj kahje në asnjë formë.

Urim Suka - a beson që ky dokument është ma i miri i mundshëm?

Sanie Kuçi Rexhepaj - nuk është ndoshta ma i miri i mundshëm por është ma i miri i kohës, dhe gjithmonë ka vend për ma mirë e ma mirë.

Dardan Berisha - ndërtime pa lej ka shumë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ndërtime pa leje ka aq shumë,sa edhe ne gjatë hartimit të HZK-së jemi mundu që në disa zona ku ka pas shumë ndërtime pa leje,sidomos rruga Suharekë-Prizren e kemi kthyer në një zonë mini industriale për shkak se po i imponohet bizneseve me i zgjeru hapësirat e veta dhe mos me pas ndërtime ilegale por legale.Pra 90 % të rasteve kemi vepru.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet

Pika 6.Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Dardan Berisha - këtu ka bo kërkesë Kryetari apo AKP-ja ia ka dhënë Kryetarit, për veq se 25 maj ka çdo kund.

Kryesuesi - faktikisht ka qenë një listë ku ajo është seleksionu.

Dardan Berisha - edhe fshati Sopijë e ka pothuaj të njetin problem.Me një takim jo formal me qytetarë,ata po dojnë me marr objektin e 25 Majit dhe me vendos Lapidarin.

Armend Krasniqi - Agjensia Kosovare e Privatizimit e ka dërgu një letër në secilën komunë për asetet që i posedon AKP-ja në komunë.Ajo ka thënë që nëse ju jeni të interesun për këto asete me i shpronësu, ju lutna që brenda afatit dy mujor të na dërgoni përgjigje nëse jeni ose jo të interesuar.Por paraprakisht këtë çështje duhet me miratu Asambleja .Unë e kam marrë shembull Studenqanin,ku 25 Maji është shkatërru dhe është rrezikshmëri.Më mirë do të ishte të priset dhe të bëhet një lloj parku në të mirë të qytetarëve.Asnjë objekt i AKP-së nuk e ka një gjendje të mirë.Ideja ime është ma shumë me i rikthyer në destinime tjera.

Urim Suka - sa është numri i aseteve të AKP-së që janë në emër të AKP-së dhe që veprojnë në komunën tonë?

Armend Krasniqi - prej numrit që kanë sjell,dikund 10-15 asete,mirëpo ne i kemi zgjedh këto.

Avni Bytyqi - siq e tha edhe drejtori,AKP-ja iu ka drejtu të gjitha komunave.Ne kemi nxjerr asetet që menagjohen nga AKP-ja e që janë në komunën e Suharekës. Gjithsej janë 17.Prej këtyre 17-ve unë me Kryetarin kemi ardh në përfundim që vetëm për 5 mundemi me procedu dhe me shpall zonë e interesit të përgjithshëm,për arsye se të tjerat kanë konteste gjyqësore.P.sh. 25 Maji në Sopijë është në pronë private,dhe ne nuk kemi interes pronën private me ja marrë qytetarit.Në Asamble secila pronë ka me pas pikën shtesë,ku e ka dhe destinimin.Zertari ligjor tutje jep sqarime për të gjitha procedurat ligjore për këtë pikë.

Liridon Fandaj - për pronat që kanë me u shpronësu,a keni bo përllogaritje se sa janë ndikimet buxhetore

Avni Bytyqi - ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës i specifikon procedurat për bartjen e pronës nga niveli qendror që menagjohet te niveli lokal.

Urim Suka - ti na the që ne në këtë material që ka ardh nuk e kemi destinimin. Për derisa ne nuk e kemi destinimin e kemi të vështirë me kuptu qëllimin dhe me vendos. Problemi është që ato asete janë jashtë funksionit dhe nëse privatizohet dhe e merr dikush, ajo kthehet në zhvillim dhe i jepet mundësia dikujt me hap vendin e punës. Pjesën e AKP-së pe di por pjesën e komunës nuk e di, që a është nevoja për park, për investim, apo me kthi në zhvillim. Unë mendoj që më mirë do të ishte me kthi në zhvillim se sa park.

Avni Bytyqi - në Kastërrc objekti është 134 metër katror dhe është i ndërtum në sipërfaqe prej 17 ari dhe ky objekt që menagjohet nga AKP-ja e ka blloku tokën e komunës. Kryetari ka ide që me bo një shtëpi të kulturës për të rinjë në Kastërrc. Në Studenqan, e tha dhe drejtori që është rrezik dhe është djeg dhe aty parashihet një kënd lojrash dhe gjelbrim, sepse janë vetëm 186 metra katror. Në Bllacë objekti është 35 metra katror dhe është i ndërtuar në parcelën prej 64 ari dhe është parapa zgjerimi i oborrit të shkollës. Në Topliqan objekti është në 4 parcela dhe janë 8-9 ha tokë, dhe ai objekt prej 505 metra katror i ka blloku 8 ha tokë. Në Duhël destinimi është ndërtimi i QMF-së. Është QMF-ja, por ne u desh me ja dhënë ni karakter të destinimit se çka me përdor ne si Komunë. Ideja është me kthi në pronë komunale dhe ne mbas 2 a 3 viteve mundemi me ndërru destinimin në Asamble.

Dardan Berisha - pra 12 tjerat kanë konteste gjyqësore.

Avni Bytyqi - po. Janë 4 objekte të Ballkanit, lokale, të cilat komuna i ka marrë në 2012 mirëpo ne kemi padi në gjykatë.

Liridon Fandaj - është një lokal te banest e Ballkanit .AKP-ja gjithmonë e qet për me dhënë në shfrytëm. A ka kontest gjyqësor?

Avni Bytyqi - ato janë lokalet që përmenda.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

Unanimisht Miratohet

Pika 7. Shqyrtimi i raportit vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditorit të brendshëm për periudhën janar-dhjetor 2021 ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - kërkoj sqarime rreth raportit të auditimit të brendshëm.

Ragip Kabashi - arsyetja e dërgimit të raportit vjetor për aktivitetet e zhvilluara nga njesia auditimit të brendshëm nuk është me ligj e parapame, as nuk është me rregullore, as nuk është me standartet e Institutit të Auditimit të brendshëm. Mirëpo MAPL-ja e ka parapa si kriter njoftimin e raportit vjetor të njesisë së auditimit për hir të performancës. Auditori tutje jep sqarime.

Urim Suka - të falemderoj për sqarimet. Unë nuk jam ekspert por po du me i ballafaqu me iden që komuna jonë nesër me pas diçka ma mirë. Ajo që unë kam lexu, auditorin e brendshëm e shoh si lloj korrektuesi të komunës mos me lan me gabu. Përveq kësaj ne kemi pas edhe një auditor të jashtëm, ku atje gjetjet janë kanë kogja të mëdhaja dhe skandaloze. Dua të di, gjetjet e auditorit të brendshëm a korrespondojnë pak a shumë në gjetjet e auditorit të jashtëm dhe a është një lloj përgjegjësie e auditorit të brendshëm ? Dhe pyetja që është në interes të të gjithëve: çka mujna me bo ma mirë për vitin tjetër?

Auditori - orientimi dhe puna e auditorit të brendshëm bëhet për vitin vijues, që ka për qëllim parandalimin e rreziqeve që mos të përsëriten. Te auditimi i brendshëm mostrat merren më shumë. Secilin vit, te auditimi i brendshëm po zbresin rekomandimet dhe po rritet adresimi.

Liridon Fandaj - a ka pas raport të 2020-tës dhe a i ke identifiku vërejtjet që ke dhënë dhe sa janë zbatu?

Ragip Kabashi - unë e cek performancën dhe të gjitha janë në performacë se sa rekomandime janë dhënë dhe sa janë zbatu. Ne dallojmë prej Zyrës Kombëtare të Auditimit që nuk kemi të drejtë me dhënë opinion për pasqyra financiare.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime shtesë dhe thotë që në bazë të ligjit për kontroll të brendshëm është dhe një Komitet i auditimit, pra njëkohësisht i raporton edhe komitetit të auditimit dhe Kryetarit. Mirëpo përgjegjësia për zbatimin e rekomandimeve dhe të gjeturave që dalin nga auditori i brendshëm është përgjegjësi e komitetit të auditimit për mi rekomandu Kryetarit që ti zbatojë këto rekomandime.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 7.

Unanimisht Miratohet

Takimi përfundoi: 14:35

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj